



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Më 20 qershor, Trupi Gjykses në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, hodhi poshtë një kërkesë të përbashkët të Mbrojtjes për apelim të një vendimi të mëparshëm të gjykatësve, me të cilin Trupi Gjykses kishte pranuar si prova dokumente të Shtabit të Përgjithshëm dhe të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës.

Në lidhje me autenticitetin *prima facie* të dokumenteve, Trupi Gjykses rikujtoi në hollësi se si kishte bërë vlerësimin e autenticitetit të secilit dokument, duke marrë parasysh një numër treguesish relevantë të autenticitetit, si nënshkrimet dhe vulat, si dhe faktin se disa nga këto dokumente i ishin sekuestruar zotit Krasniqi.

Lidhur me kundërshtimin e Mbrojtjes se Prokuroria i dorëzoi këto dokumente për pranim në fund të paraqitjes së provave të saj, Trupi Gjykses theksoi se, përmes listës së provave materiale të dorëzuar nga Prokuroria para se të thërriste dëshmitarët e saj, Mbrojtja ishte informuar për synimin e Prokurorisë për t'i përdorur dhe për t'u mbështetur në secilin prej këtyre materialeve që në fillim të procesit.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit lidhur me pretendime për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi vendime mbi disa mocione paraprake të Mbrojtjes.

Më 19 qershor, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vendosi mbi një mocion paraprak të Mbrojtjes së Thaçit me të cilin kundërshtonte juridiksionin e gjykatës. Ndër të tjera, Mbrojtja e Thaçit, argumentonte se pretendimet për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve duhet të ishin trajtuar nga Trupi Gjykses në çështjen gjyqësore të z. Thaçi për krime lufte, dhe jo si çështje gjyqësore më vete nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake.

Në arsyetimin për hedhjen poshtë të këtij kundërshtimi, Gjykatësja e Procedurës Paraprake theksoi se, sipas ligjit, vetëm Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe Gjykatësit të Procedurës Paraprake u takon roli i dorëzimit dhe i miratimit të Aktakuzës. Gjykatësja konstatoi se kjo nuk ndikon në aftësinë e Trupit Gjykses në çështjen gjyqësore të zotit Thaçi për krime lufte për t'i mbrojtur të drejtat e tij për gjykim të drejtë. Ajo konstatoi se asnjë nga shembujt e paraqitur nuk mbështetnin pretendimin se zotit Thaçi i është cenuar e drejta për gjykim të drejtë.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake hodhi poshtë gjithashtu pretendimin e z. Thaçi se ajo nuk duhej të ishte caktuar edhe si Gjykatëse e Vetme gjatë hetimit të Prokurorisë, edhe më pas, si Gjykatëse e Procedurës





Paraprake. Në arsyetimin e saj, gjykatësja theksoi se nuk ishte paraqitur asnjë argument i bazuar se si mund të ndikonte kjo në paanshmërinë e saj dhe se shqetësime të këtij lloji duhej të ishin ngritur nëpërmjet një procedure tjetër.

Më 24 qershor, Gjykatësja e Procedurës Paraprake hodhi poshtë mocionet paraprake të ekipeve të Mbrojtjes të Thaçit dhe Fazliut, që ngrinin pretendime për mangësi në Aktakuzë. Ndër të tjera, në vendimin e saj, gjykatësja konstatoi se Aktakuza përmbante hollësi të mjaftueshme lidhur me akuzat për tentativë për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare.

Ajo konstatoi gjithashtu se kontakti i paligjshëm i pretenduar midis z. Thaçi dhe vizitorëve të tij ishte mjaftueshmërisht i qartë në Aktakuzë, bazuar në nxjerrjet e materialeve të vizitave jo të privileguara, ku pretendohet se ai u dha udhëzime të bashkakuzuarve të tij për t'ua përcjellë dëshmitarëve të mbrojtur.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake është bindur gjithashtu se niveli i hollësive për përfshirjen e z. Fazliu në veprimet e pretenduara që lidhen me dëshmitarin 1 është mjaftueshëm i qartë. Sipas vendimit të gjykatës, aspekti nëse provat janë të mjaftueshme apo jo për vërtetimin e fajësisë në lidhje me akuzat në Aktakuzë do të diskutohet gjatë gjykimit.

Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi një vendim tjetër më 20 qershor, lidhur me një kërkesë të mëparshme të Mbrojtjes së Kilajt për qasje në disa parashtrime, ku vuri në dukje se Mbrojtja e Kilajt kishte tërhequr disa pjesë të kërkesës, ndërsa parashtrimet e tjera ishin riklasifikuar për t'ua vënë në dispozicion të gjithë të akuzuarve në këtë çështje gjyqësore.

